



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI"  
DREJTORIA EKONOMIKE

PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT

Studentët që vazhdojnë studimet në të tre sistemet e shkollimit: koha e plotë (dita), koha e pjeshme, korrespondenca klasike, në të tre nivelet e studimit: DNP, MNP, DND të kryejnë pagesën e tarifës së shkollimit (për Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan) dhe taksës së shkollës (për Drejtorinë e Tatim Taksa, Elbasan) për vitin akademik 2009 – 2010.

Pagesa të kryhet vetëm sipas të dhënave të përcaktuara në formularin "Fletë pagesë – Tarifë shkollimi – viti akademik 2009 – 2010", i cili është emetuar për çdo student.

Ky formular gjendet:

- në faqen e internetit: [www.uniel.edu.al/](http://www.uniel.edu.al/) /  
\_informacione/ formular
- në Drejtorinë ekonomike/Shërbimi financiar

Procedura që duhet të ndiqet për shkarkimin e formularit nga interneti:

1. futuni në adresën [www.uniel.edu.al/](http://www.uniel.edu.al/)
2. futuni tek rubrika [Informacione/formular](#)
3. zgjidhni skedarin "Formular derdhje\_2009\_2010\_T\_shkollimi.pdf", i cili është në PDF" dhe hapeni atë.
4. Në dritaren "Find" ose Edit/Find – shkruani emrin ose mbiemrin dhe do të gjeni formularin tuaj, i cili përmban të dhënat tuaja si student: sistemin e shkollimit, programin

e studimit (dega), vitin, tarifën e shkollimit që duhet të paguani, taksën e shkollës.

5. Printojeni fletë pagesën.

Fletë pagesa të paraqitet vetëm pranë bankës (të cilësuar në fletë pagesë) për të kryer pagesën

**Pagesa të kryhet duke filluar nga data 13.11.2009 deri më 15.12.2009**

**Moskryerja e pagesës brenda afatit të përcaktuar ju penalizon: në marrjen e librezës së studentit (për vitin e parë), në futjen në provim në sezonin e parë të provimeve (pavarësisht nga kryerja ose jo e pagesës pas datës 15.12.2009)**

*Formulari i pagesës me vulën e bankës dhe dokumenti i transfertës me vulën e bankës, të dorëzohet nga studenti në UE/Drejtoria ekonomike, për evidentimin e detyrimit të paguar nga studenti, ndryshe nuk i njihet pagesa e kryer. Dorëzimi i dokumenteve të mësipërm të kryhet menjëherë pas kryerjes së pagesës.*

Tel: +3555426821 Ext: 110  
Cel: +355 69 20 71085  
E-mail: [filip.qosja@uniel.edu.al](mailto:filip.qosja@uniel.edu.al)  
Web: [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al)